

VENDIM
Nr. 77, datë 8.2.2006

**PËR LEJIMIN E INSTITUCIONEVE BUXHETORE DHE TË NDËRMARRJEVE E
SHOQËRIVE ME KAPITAL SHTETËROR TË PËRDORIN PROCEDURËN
“PROKURIM I DREJTPËRDREJTË” PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË
MJETEVE MOTORIKE, PËR PËRGJEGJËSINË NDAJ PALËVE TË TRETA**

(Ndryshuar me VKM nr. 177, datë 29.3.2006)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr. 7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Institucionet buxhetore, për fondet limit, të miratuara në buxhetin e vitit 2006, dhe ndërmarrjet e shoqëritë me kapital shtetëror, për fondet nga të ardhurat e tyre, të lejohen të përdorin procedurën “prokurim i drejtpërdrejtë”, me INSIG, sh.a., për sigurimin e detyrueshëm (TPL) të mjeteve të tyre motorike, për përgjegjësitë ndaj palëve të treta *dhe sigurimin e jetës*.

2. Primi që INSIG sh.a. do të arkëtojë nga institucionet buxhetore dhe ndërmarrjet e shoqëritë me kapital shtetëror, të jetë vlera e primit të pastër, plus vlerën e shpenzimeve administrative.

3. Ngarkohen drejtuesit e institucioneve buxhetore dhe të ndërmarrjeve e shoqërive me kapital shtetëror për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha